

VASIL DEDE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-1
852

Lule mbi burime

POEZI

884-1

032

VASIL DEDE

LULE MBI BURIME

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje.

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976

PËR VETEN

Bir bujku jam dhe e kam për nder
që, kur erdha në jetë, u rrita me fshatarë;
nëna në samar të pelës më përkundi,
me vete më merrte në kopsht, në arë.

Në një fshat malor linda unë,
ku pranverat me fshatarët prita;
sa herë dhentë zbrita në lumë
dhe arat me misër prashita.

Sa herë korra atë që vetë mbolla
e hodha në brazda grurë të ri...
Nëse flokët i kam ngjyrë gruri
do të thotë se jam rritur mes tij.

Fytyra ime nën dellin e korrikut larë,
erë toke duart më mbajnë vërtet;
që kur linda njëzet vjet më parë
dashurova tokën që të bën poet.

Dashurova fshatin, njerëzit, jetën,
dashurova krojet, barin, çdo gur
se pa to, o njerëz, t'ju them të drejtën,
një bujk i mirë s'do bëhesha kurrë.

LIRIKA E NËNËS

Në fshatin e largët me njëzet shtëpi,
që të parët e quajtën Postenan,
rron nëna ime Agathi
që gjashtëdhjet' vjet mbi supe mban.

Më përçolli flokëthinjura në institut
buzë një mëngjesi të bukur, të bardhë,
dhe dorën e butë më hodhi në sup
«Udhë të mbarë, bir; hap sytë, djale!»

Dhe duart ç'm'i ngriti nga larg
asaj here jo si çdo ditë;
në sytë e saj më i bukur varg,
në sytë e saj më e ngrohta lirikë.

Këto nënët tonë ç'i djeg malli
ndaj emrat tanë zënë shpesh
dhe thonë të lumtura: «Përcolla djalin!»
si nëna ime këtë mëngjes.

Dhe duart ç'm'i ngriti nga larg
asaj here jo si çdo ditë;
në sytë e saj më i bukuri varg,
në zemrën time dhe kjo lirikë...

GURË DHE THËLLËZA

Në këta gurë rriten thëllëza,
i keni parë si fërfeljoinë mbi burime
e rrakin krahët në male, në rrëza
në mbrëmje të vona dhe agime?

I keni parë ju thëllëzat, vallë,
kur grumbuj-grumbuj mbi gurë rrinë
dhe këngë lënë në fijet e barit,
dhe gjer në fshat kur duan vijnë?

I keni parë ju thëllëzat tona
kur zbresin në verë mes arave
dhe rrinë në mbrëmjet e vona
buzë këngës e qeshjes së vajzave?

O, i keni parë thëllëzat, patjetër,
kur krahët nderin në agim...
Kush tha se gurët tanë fytyrëegër
s'e njojin vallë bukurinë?!

L I R I K Ë

Këtu gruri ndrit si balli i shoqeve
dhe si shi i artë thasëve shket,
kallinjtë këputen nga pesha e kokrrave
ndërsa mbrëmja pëshpërit e flet.

Kombajnere, mos e ndiz fenerin,
natën e kaltër s'e shikon si qesh;
s'e shikon ti grurin kur ul belin
sikur po të flet diçka në vesh?

S'e dëgjon, s'e dëgjon ti këngën
kur nga gjoksi i fushës rrjedh kaq qetë
dhe vë buzët te kallinjtë e rëndë,
dhe me grurin puthet lehtë e lehtë?...

KU ISHE MBRËMË TI?

Bariut Sofo që nuk fjeti gjithë
natën për të shpëtuar shelegun e
kooperativës.

E hedh ngadalë rrëth zverkut
e vrapin e ndal te stani;
këmba e thyer e shelegut
varet si kërrabë çobani

Dhe gjumi qepallat s'ia mbyll,
mbi gunë atë natë s'u shtri;
dhe era kuis tej në pyll,
shelegu rënkon si fëmi.

Bukën nga torba s'e nxjerr,
e shoqja e pret në shtëpi;
gunën shelegut ia hedh,
shelegu rënkon si fëmi.

E këmbën shelegut ia çon,
e këmbën ia lidh me shami;
dhe rreze agimi lëshon,
shelegu vështron si fëmi.

U mblodhën fshatarët te stani,
e pyetëm ku mbrëmë ai ish;
dhe qeshte i lumtur çobani,
në tufë shelegun e kish. . .

*

* * *

Muzgu ra. Një cipë e lehtë
veshi fushat rreth e rreth.
Vashëz' e re qerpikdrejtë
grurë korri, këndon e qesh.

Gruri i ri kallirënduar
kokën ul e flet diçka
si njeri i menduar
me mendime të mëdha.

I çon lart qerpikët gruri,
vajza këngës prapë ia merr;
mbrëmja ngjyrë gushëpëllumbi
erë buke në fshat sjell. . .

VAJZAVE NË VALLE

Kështu ju pafsha, vajza,
mes gazit e valleve,
ju këndoftë zemra
përherë festivaleve.

C'ma përdridhni belin
lehtë e mengadalë;
njëra flet me sy,
tjetra me qepallë.

Vajza kolonjare
nëpër valle humb,
seç i zbardh shamia
si vala me shkumë.

Vallja më e mirë
ç'vjen rrrotull në sallë;
gazi shket në buzë
i pastër, i bardhë.

KUR ÇELIN LULET E QERSHISË

18 herë qershia mbushi lule e fletë,
vajza e xha Kiços mbushi tetëmbëdhjetë.

Tani qershia ka çelur përsëri
si ëndrrat e Albanës në zemër, në sy.

C'pati Albana që u vonua mbrëmë
nën lulet e qershisë spërkatur me hënë?

Nën degët e qershisë djali e priste
gërshetat e zes ia shplekste ia lidhte.

Ëndërronte nën degët e lumtur Albana,
muzikë të gëzuar kish radio Tirana.

Dhe çelte kënga si lule qershish
në sytë e të rinjve ylber dashurish.

ASAJ QË SHPEJT DO TË RRITET

Kjo Vjollca e vogël më shikon dhe qesh,
mua dielli i syve të saj më ngroh zemrën.
O zogëzë e bukur, mirëmëngjes!
Kur do të çohesh dhe ti më këmbë?

Të kalosh një urë e një lumë
si daja yt, moj, mëngjes për mëngjes.
Ti do bësh rrugë ndoshta më shumë,
o vogëlushe që shikon e qesh.

Mos u çudit! Dhe ti rrugë do marrësh
e do vravosh me shokët shpejt transheve,
nga shoqet ti e para do të dalësh
e në marshime do t'ua kalosh djemve.

Do kalosh një urë a më shumë
si daja yt, moj, mëngjes për mëngjes, —
veç mos harro, në rrugë do gjesh gjurmë
dhe gjurmët të takon më tej t'i shpiesh.

KËNGË MË VETE PËR VJOLLCËN

Tani vogëlushja Vjollcë flë në shtratin e butë,
dielli nga dritarja i puth buzët, sytë.

Është 1 Qershori, fillimi i një dite,
brenda një krevati rrinë pesë vite.

Babi heq xhaketën, mami shkon në punë;
ç'mendon vajza vallë, ç'ëndrra sheh në gjumë?

Është mbushur plot tryeza e Vjollcës
në vijat e gotës— duart e së motrës.

Dhe duart e nënës te mbulesë e shtratit,
duart e babait te bojë e krevatit.

Është 1 Qershori, lindja e një dite,
një krevat i vogël dhe plot pesë vite.

AROMA E GRURIT TË PJEKUR

Kjo aromë e grurit të pjekur
më rrëmbeu këtë mbrëmje të butë,
asgjë tjetër në fshat s'më ka dehur
sa era e këndshme e bukës.

Unë ndjej fëshfërimën e lehtë
edhe humbem në ëndërr i téri,
çdo fshatar më duket poet
tek mendon për duajt te lëmi.

C'kam kështu këtë mbrëmje, s'e di,
tek rrjedh gruri në thasët e gjerë?
Nuk po flë, në një vend nuk po rri
në çdo gjë shoh një varg, shoh një këngë.

Nuk e di ç'kam kështu, pse jam dehur, —
ç'mund të them këtë mbrëmje të butë?
Kjo aromë e grurit të pjekur
kësaj mbrëmje s'më lë t'i mbyll sytë.

P E I S A Z H

Livadhit tē gjelbér shushurin ujë kroji,
era, si dirigent, duar pemësh ngre,
mbi fijen e barit agimi lotë pikoi
e zogjtë lirikat i derdhën atje.

Poshtë rrugës tringëllijnë këmborë,
këtu qindra melodi do tē dëgjosh,
era e malit ulet si në dorë,
me flokët e dhene qesh e loz.

Tej bregut del çobank' e malit,
dielli nxjerr ballin, e ul mbi kodër,
lot' i agimit nis e shkrin barit,
delja kérkon qengjin e vogël...

* * *


Ai, ajo dhe shtegu përballë.
Era tund gjethet e misrit
e shiu derdhet ngadalë
mbi gojën e hapur të plisit.

Toka gjithçka sot e mori
e gjoksi iu ndez zjarr e flakë,
djaloshi dy duart i hodhi
mbi bluzën e saj ngjyrëmjaltë.

Era tund gjethet e misrit
e shiu rrëshqet mbi kërcell,
kjo era e vakët e plisit,
tek shkrihet, të josh e të vel.

Me vajzën të zënë përdore,
vlaga si tyl i mbështjell —
kaq dashuri njerëzore
rrallë s'e gjen veç këtej...

12015



E Ç A S T I T

Si një shqerrkëz e bardhë më vjen
ndërsa dhentë kullos nëpër bjeshkë;
ja, qelli u bë ngjyrëkrem
si sytë e tu larë me vesë.

Pranë kësaj vjershe vjen e rri
sikur do t'i shtosh diçka më shumë.
Dhe heshtja flet, ti këtë e di,
ndaj nuk mërzitesh kur s'flas unë.

«E di, më thua, vjershat duan punë» —
dhe dorën rreth ballit më kalon;
mua zemra më gufon si shkumë
në qumështin e ngrohtë mbi bidon.

E zërin tënd lirik e fus në vjershë,
përzier me qumështin e stanit;
filladi na sjell erë lule pjeshke,
dhentë këpusin majën e barit.

I M A Z H F È M I N I E

Kur isha i vogël dhe lindte dielli
vrapoja ta bija te kodra e fshatit;
veç, sa veja atje ma merrte qielli
ndaj i lodhur zbrisja monopatit.

Kur isha i vogël e ndiqja hënën netëve,
një herë një shkop të gjatë bëra, —
ajo më fshihej kumbullave e pjeshkëve
duke më lodhur me orë të tëra.

E unë shtrija drejt qiellit duart,
e çoja ëndrrat lart trumba-trumba;
retë e qiellit më bëheshin si kuaj
dhe rendja unë mbi to ku mundja.

Po hënën flokartë s'e zura
as diellin e madh s'e zura unë
sepse para se të merresha me ta
për tokën duhej të bëja më shumë.

HAPI SYTË E ZES

Në ballin e bukur, në ballin shteg mali
plumbi i armikut qëlloi komisarin.

Rreth e qark kish male, gurë kish dhe bar;
gjoksi i komisarit ende digjte zjarr.

Dhe tufat e barit në shkëmbin e çarë
kokën poshtë e ulën dhe në heshtje qanë.

Ballin, komisar, plumbi ta ka marrë,
hapi sytë e zes dhe na sill beharë!

Hapi sytë e zes dhe na sill lirinë,
grumbuj-grumbuj shokët mbi kryc të rrinë!

Shokët zbresin malit porsi vetëtimë, —
hapi sytë e zes të shohësh lirinë!

VARGJE PËR PARTIZANIN VELI

Thonë se atëherë ishte pranverë,
me gaz e bujë këndonte bilbili,
jargavanët sapo kishin çelë,
luadheve ngadalë rritej trifili.

Thonë se ish më i vjetri në brigadë
e mbante në brez një pagur të vjetër,
nga supi s'e hiqte belxhikun e gjatë,
për sy Veliu ishte mjeshtër.

Thonë se ish më gazmori në brigadë,
e qeshura nga buzët s'iua shua kurrë;
i qeshur ish dhe atë natë
kur e gjetën shtrirë tek ara me grurë,

kur currila uji pikonte paguri
mbi grurin e pjekur në arën e thatë,
kur nga pesha e trimit ish shtrirë gruri,
kur zogjtë u fshehën nën një lofatë,

kur në tokë qe derdhur duhan i grirë,
kur shokët u shtrinë nën një koçimare,
kur komisari u përkul mbi trimin
dhe dielli i lirisë po shkrepte mbi male...

O R E M U L L I X H I

Të më bluash grurin, ndaj erdha nga mali,
ore mullixhi mustaqepadirsur.

Ujët nuk ka ardhur, éshtë zënë jazi,
moj fshatarja ime qerpiçakërdisur.

Gruri duhet bluar, një çetë po pret
ku zbardhojnë retë, lart në ato male.

Në vijë të mullirit ujin do ta sjell,
moj fshatarja ime, moj vetullgajtane.

Të më bluash grurin pa dalë ylli i dritës,
ore mullixhi rritur me mundime.

Uji vjen i turbullt, më zuri koritën,
moj fshatarja ime, luftëtarja trime.

Ujin kulloj unë me duart e mia,
ore mullixhi mustaqepadirsur.

Po nuk mbajnë gurët, éshtë çarë vija,
moj fshatarja ime qerpikçakërdisur.

E në s'mbafshin gurët, do vë unë trupin,
ore mullixhi rritur me mundime.

Bashkë do sjellim ujin e do bluajmë grurin,
moj fshatarja ime, luftëtarja trime.

PARTIZANIT ALEKS

A. Babali

Ish ditë dimri, ish mëngjes,
mbi male vareshin retë
kur u vra partizani Aleks
atje në shkëmbinjtë e sertë.

Nga dhembja lotoi dhe bari,
gushkuqi këngën la në mes...
Në heshtje u ul komisari
kur u vra partizani Aleks.

Kënga nga gjokset u ndez,
dielli po dilte nga mali...
Kur u vra partizani Aleks
dalngadalë po vinte behari...

D H J E T Ė U S H T A R ē

Ishim dhjetë ushtarë,
rendnim nëpër udhë;
djersa mbi qepallë
ishte bërë shkumë.

Ajri dridhej shumë
përmbi fije bari;
plot dhjetë pagurë,
plot dhjetë armë zjarri.

Ecnim që të dhjetë
vrap në njëshkolonë,
malet kurrizmprehtë
ndjenin hapin tonë.

Ruga ish e gjatë
male, pyje, fusha;
dielli mbi helmetë
binte si me grushta.

Ishim dhjetë ushtarë,
shokë kishim malet;
yjet përmbi ballë
shkëlqenin si zjarre.

Lodhjen bëmë këngë,
kënga udhët mori;
mal' i madh, i rëndë
grykash e përcollë.

NË VENDLINDJE

Shpeshherë kur shkoj në fshatin tim
s'më rrihet pa dalë kodrave dhe arave.

— Është agronom, — thotë dikush, — pa diskutim !—
tek më sheh këmbëkryq ulur ugareve.

Pa iu ngjitur malit mua nuk më rrihet,
dua të pushtoj horizontet skaj më skaj.

— Është gjeolog, thotë dikush, — kjo dihet! —
tek më shikon majë malit të dal.

Ç'MË MBANI MËRI?

Pemët në mes kopshtit qenkan rritur,
këtu të josh, të deh era e pjeshkëve;
përmbi gjoks të ledhit të kositur
shfaqen përsëri gjurmët e fletëve.

Sipër meje duart zgjat një degë
sikur të më thotë: Erdhe ti?
Shkundi kokrrat, pjeshkë, e bukur pjeshkë,
një ma fut në xhep e një në gji.

S'kam ndryshuar unë vargjet, rreshtat,
ç'më mbani mëri, kokrra ndër degë?
Ai djali jam që shkruante vjersha
përmbi trungun tuaj ngjyrë gështenjë.

Ai djalë jam që kam qenë
kur mbi degët tuaja ditën rrija
e mes fletësh vërvhelleja këngë
e një kokërr degëve s'u lija.

Ç'më mbanë mëri sot, pemë, mua?
Shkundi kokrrat, pjeshkë, e bukur pjeshkë, —
unë kam ardhur në fshatin që dua
ku kam zënë rrënje e hedhur degë.

*
* *

Mbrëmja e kaltër porsi flutur
vjen e ulet supit tënd, —
shiko fshatin, sa i bukur
përmes dritash ngjyrëargjend.

Shiko dritat në çdo shtyllë
buzë xhadesë vënë varg,
s'e sheh si thërrmohet ujët
pranë çezmës në sofat?

S'i sheh qengjat, ja ku janë
tek vrapojnë ndër livadhe;
eja dalim nëpër arë,
mbiu fara ndër ugare.

Shih pranverën si tund krahët,
blegërin qengji akoma.
A gjen mbrëmje kaq të kaltër
sa këtej në fshatrat tonë?...

DO TË JETË MËNGJES

Do të jetë mëngjes dhe zogjtë mes fletëve
do të këndoijnë të tjera lirika...

Të dy të lumtur do të rendim bjeshkëve
e unë do të të them: Më do, moj Rita?

Ti do të ulësh qerpikët e zinj
sikur të më thuash: Ç'thuas kështu?
Unë dritën e syve do ta ul si diell
mbi gjolin e pastër të syve të tu.

E zogj të tjerrë do ulen mbi burime,
do rrahin krahët ndër hapësira,
do pëshpëris unë: O Rita ime,
ti je më e bukura, ti je më e mira!

Po ti qerpikët e zinj nuk do t'i ulësh
së të pëlqen kur të thérres: o Rita!
Do jetë mëngjes dhe zogjtë në udhë
do kompozojnë të tjera lirika...

SOFIKËS SË KOLONJËS

*As më thuaj një fjalë,
të keqen e gojës...*

P o p u l l o r e

Ke dalë e më rri
buzë një ugari,
të kam përkarshi
e s'ngopem së pari.

Shoqet lanë shatat
të dëgjojnë zënë,
të dëgjon brigada,
të dëgjon jot ëmë.

E flet ti kaq qetë,
të keqen e gojës,
e qeshur, e thjeshtë,
Sofikë e Kolonjës..

T'i ka njomur flokët
vesa ndër ugare,
rreth e rrotull shokët
si harku në valle.

Brigadierja jonë,
ti sa bukur flet,
shpesh shoqet të thonë —
erdhi dasma, ç'pret?

E buzën në gaz
e vë ti ngadalë,
thua se në çast
do i ftosh në garë.

Ç'thotë zemra, ç'thotë,
të keqen e fjalës?
Dasmën do ta bëjmë
në mesin e arës...

V J E S H T Ė

Këtë vjeshtë pemët kanë bërë tepër
dhe era e mollëve të deh kopshteve;
mbi vija, mbi rrugë bien fletët
dhe ushtarët e rinj hyjnë postblloqeve.

Vrapojnë në vreshta Zetorët,
nga spondet pikon lëngu i rrushit;
vjeshta e çau kraharorin,
tokës mbi gjoks i derdhi mushtin.

Kalojnë në rreshta ushtarët,
shih sytë e transheve si qeshin;
në rrugë kanë ndalur shkollarët,
ushtarët me dorë përshëndesin.

Dhe mushtin e ëmbël shtrydh vjeshta
e tokës mbi gjoks ia derdh gjirin;
vrapojnë ushtarët në rreshta
vjeshtës ia shtojnë blerimin.

KËNGË E RE MBI BRAZDA ÇEL

*Cili tē pēlqen, moj bijë?
Ai që këndon më mirë.*

P o p u l l o r e

Katër vajza dorë për dorë
ngjiten ulen mbi traktorë.

Dallgë brazdash ka në fushë —
katër vajza gushë më gushë.

Qerpiklagurat në djersë
janë çuar në mëngjes.

Katër vajza në një fushë —
këndojnë katër gushkuqë,

Këndon ujët mbi zabel,
këngë e re mbi brazda cel.

Katër djem trima azgënë
ngjiten ulen mbi kombajnë.

Ballëlagurit në djersë
korrin grurin në mëngjes.

Katër djema në një fushë —
kridhet dielli në gëmushë.

Katër vajza, katër djem
— Bijë cili të pëlqen?

— Ai që punon më mirë,
flokëgruri në kabinë.

Katër vajza, katër djem
— Djalë, cila të pëlqen?

— Ajo që punon më shpejt,
qerpiklagura në djersë.

Këndon ujët mbi zabel,
këngë e re mbi brazda çel...

ËNDERRA E MJELËSES

Tek milte lopët synjoma e të urta
i erdhi t'i puthte të gjitha me rradhë;
ato të mirat, të bukurat, të butat
lëshonin në kova qumështin e bardhë.

Një fije jonxhë i kish rënë në qepallë,
shamia bukur i mbulonte flokët;
kundërmonte erë qumësht në stallë
dhe gjelbërimin përtypnin lopët.

Dhe kur bidonët u rënduan tepër
e karrocieri priste në oborr
ia shfaqën vajzës fëmijët e vegjël
me gotat e qumështit në dorë.

Atëherë zemra i rrahu në gjii,
provoi një ndjenjë të ëmbël, njerëzore...
I dukej sikur e uronte nga larg çdo fëmi
me buzët e kuqe të mbushura, qumështore.

NË LUKOVË

Këtu mëngjeset janë si sytë e vajzave
e qerpikët e bukur çel çdo mbrëmje,
ne mbjellim limonë tarracave
sa puthet dielli me valët çapkëne.

Këtu ndrisin më fort rrezet e hënës
e lozin e qeshin mbi kokrra çdo natë
si duar fëmije në qafën e nënës
duke i përkëdhelur me dorën e artë.

Këtu limonat na mbijnë në sy,
mbushur me kokrra, më shumë se fletë, —
ne do kujtojmë gjithçka këtu
kur nesër t'i shtrydhim tryezës së thjeshtë.

VËLLAI

Vëllai im ka tre fëmijë gjithë shëndet,
si tre bisqe shartuar në një degë.

Kur qeshin ata dielli shkëlqen më mirë
e në dhomë çelin tre trëndafilë;

e tre pëllumba fluturojnë në oborr
kur këngës ia marrin të tre si në kor.

Mbrëmjeve kur vëllai kthehet nga Fierza
të tre i varen në qafë si tre rrëkeza.

Ai i merr në krahë, u puth buzët e njoma,
për punën u tregon... Ata duan akoma.

Pastaj të katër këngës ia marrin menjëherë
dhe lodhja e ditës kalon pa u ndjerë.

NAFTËTARI BRAHO

Naftëtarin Braho do ta gjesh pusevc
me torbën hedhur shpatullave të gjera
dhe me buzëqeshjen e madhe që i derdhet syve
siç derdhet nga duart e tij në tuba nafta.

Naftëtarin Braho përshëndet dielli të parin
duke i mbështetur ballin e artë supeve;
ai e sheh si lëviz nën këmbët e tij nafta
siç sheh bukurinë e mëngjeseve, e luleve.

Ai edhe natën flet me nëntokën,
siç flet me fëmijët çdo ditë,
naftëtarin Braho do ta gjesh puseve
në bisedë intime me thellësitë.

Në çdo pikë nafte është dora e tij,
dora e fuqishme, e ashpër, e madhe;
thua se me damarët e kaltër të tij
bashkohen arteret e puseve të ardhme.

VAJZA E FABRIKËS SË QELQIT

Thua se në gishta kish ngjyrat e agimit
dhe vesën e livadheve kish mbledhur me kujdes,
në faqet e gotës lule lëndine mbinin
siç mbinin ëndrrat në sytë e saj të zes.

Më vinte t'i merrja ato lule,
të paktën si kujtim të kisha një,
po lulet që dilnin nga dora e saj
shkriheshin në gotë, s'dilnin më.

Po lulet që dilnin nga dora e shpejtë
me lulet e diellit më ngjanin mua,
thua se në gishta kish diellin vetë
dhe e pikonte thua më thua.

NËN DIELLIN E KORRIKUT

Ish ulur im atë në ledh të arës,
vështrimin kish tretur mbi grurë,
ndërsa gruri pëshpëriste ngadalë
sikur do të thosh: «U poqa shumë!»

Im atë mbushi pëllëmbët plot
dhe tha: «Ky grurë s'ka farëra të egra»,
po ç'm'u kujtuan mua ca vjersha sot
që kanë brenda vargje të tepërtat?

Shkëlqente gruri në pëllëmbë të babait
nën diellin e korrikut syflorinjtë...
Përse këto vjersha mos shkëlqejnë si gruri,
përse të mos rëndoijnë si kallinjtë?

MËNGJES

Këtë mëngjes dielli hyri në të gjitha dritaret
si një mysafir i dashur, i mirë...

Vogëlushja Lidë u nis me shkollarët,
motra la turnin,
vëllai u nis në uzinë.

Postjerët rendin të shqetësuar
e pëllumbat e letrave nisin larg,
e treni i rëndë trokon pa pushuar
trak e trak, trak e trak.

Dal edhe unë këtë mëngjes,
unë i dashuruari i udhëve, i zhurmës, i luleve.
Eci. Blej gazetën. Përshëndes.

Dhe përsëri me shokët marr udhët.

Ndrisin si në festë sytë e këtij qyteti
e fëmijët e kopshteve kalojnë trotuarin.

Thith i etur frymëmarrjen e këtij mëngjesi.
Eci. Përshëndes. Lë pas bulevardin.

Zënë e ngjiten punëtorët skelave.
Eci drejt tyre, shokët të arrij.
Përshëndes. Qesh. Dëgjoj këngën e trenave
trak e trak; trak e trak, po vij...

D O TË V I J E . .

Do të vije,
patjetër do të vije,
dhe në këngët e mia të ngrohta
një lirikë të re do të lije.

Do të vije,
si s'do të vije?
Dhe në ëndrrat e mia të kaltra
një ëndërr të bukur do të lije.

Do të vije,
patjetër do të vije,
dhe në qiellin tim të lumturisë
balona gëzimi do të ngrije.

Do të vije,
si s'do të vije?
Dhe në mendimet e mia të shumta
një shqetësim të bardhë do të lije . . .

LULE MBI BURIME

... Dhe thonë se shqiponjat tonë janë të egra,
se vetëm shkëmbinjve të jetojnë dinë,
po sa herë i shohim tek zbresin të qeta
e ulen mbi burime në lëndinë?

Sa herë ulin kokën përmbi fije bari,
sikur t'i dëgjojnë frymëmarrjen tokës,
a s'ua shihni kthetrat plot baltë ugari,
kallëzat prej gruri s'ua shihni rrith kokës?

E tek rrahin krahët mbi arat e mbjella,
me vështrim nga shkëmbi ku zbardhojnë retë,
(mes tri maja malesh tek i pret foleja)
këto janë rritur, thua, me rrufetë.

Po sa herë i shohim tek zbresin të qeta
e nga kthetrat ulin lule mbi burime.

...Dhe thonë se shqiponjat tonë janë të egra
ata që i tremb çdo gur i tokës sime.

POEMË PËR GJYSHIN

Unë s'e mbaj mend gjyshin Koli,
im atë më ka folur për të
se kishte qenë një bujk i zoti
që tokën e punonte si jo më.

... Kishte pasur një pendë që
që i donte si ajrin, si dritën;
djersën nga vithet ua hiqte me nge
kur tokën lëronte gjithë ditën.

Tregon im atë, kur i ngordhi kau,
atje në arë midis plisave,
buzë ugarit me dhembje qau
sa zogjtë u strukën mes lisave.

Nofullat e gjera kish qepur
dhe vështronë tokën zallishte
dhe kaun e vetëm që kish mbetur
tek përtypte në ledh misërishte.

Në sy i rrinë dy djemtë
që me bukë s'u ngopën kurrë;
i dilte e shoqja me barkun te goja
që shpresonte të kishte pak grurë.

Dhe shtëpia me halle, me vuajtje
ku shiu futej parreshtur,
dyshekët e mbushur me byk kashte
parmenda në arë e pamprehur...

*

* * *

C'do hanin fëmija,
ç'do gatuante nëna?
Te pragu i shtëpisë
mezi hynte hëna.

Në një cep të errët
rrinte magjia bosh —
e heshtur, e vrerët
si një plak ulok.

Po e vishte myku
magjezën e shkretë,
tej në ara gjyshi
më s'i ngiste qetë.

Tej në ara gjyshi
nxinte si ugari
nga jeta me halle,
nga jeta gur varri.

C'do hanë fëmija,
ç'do gatuajë nëna?
Bukë s'ka shtëpia,
dritë s'lëshon hëna.


*

* * *

Sa kish ëndërruar gjyshi, ti s'e di,
të nxirrte një thes grurë nga ara,
ta çonte pastaj tej fshatit në mulli
dhe gruas së dashur t'ia vinte para.

E t'i thosh: «Solla bukë të hanë fëmija,
magjen e mykur laje, moj grua,
dhe fshati po të vijë te shtëpia
jepu një grusht miell ti nga mua.

Po në arë e heshtur ngeli parmenda
e bari i egër rritej nëpër brazda
e toka rënkonte nga çizmet e rënda,
e mira, e lodhura, e vuajtura.



Tokë, moj e dashur,
bëna grurë të ri,
të kenë fëmija
bukë në shtëpi.

Magjja të na mbushet
sa të derdhet brumi,
faqja gjak t'u skuqet
djemve të katundit.

Hidh sytë përpjetë,
tej në ato male;
nuk i sheh ti djemtë
si po ndezin zjarre?

Nuk e sheh ti gjyshin
me torbë e fishekë,
si ngjitet te shkëmbi
ku zbardhojnë retë?

Tokë, moj e dashur,
buzëzezë nxirë,
e lodhur, e vuajtur
e dashur, e mirë.

*

* * *

Unë s'e mbaj mend gjyshin Koli,
im atë më ka folur për të
se kish qenë luftëtar i zoti
që pushkën e përdorte si jo më.

Kur shkoi në mal bashkë me shokë,
me belxikun e rëndë mbi supe,
tha: «Dua liri, ndryshe këtë tokë
ta lyejmë, vëllezër, me të kuqe!»

Tri herë armiqtë e morën në shenjë
e të tri herët nga shënjestra u shkau, —
e priste e shoqja në netët me hënë,
kish kohë që priste në grazhd dhe kau.

E priste brazda e lënë në mes,
parmenda nga streha duhej të dilte;
fëmijët te kodra rrinin çdo mëngjes,
magjja e mykur të mbushej priste.

*

¶ ¶

Të hanin fëmija,
të gatuante nëna;
pragun te shtëpia
ta ndriçonte hëna.

Parmenda tē mprehej,
tē futej nē ara;
bari i keq tē digjej,
tē pēlciste fara.

Tē rritej kalliri
i fortē, i drejtē
gruri si floriri
tē mbushte lēmenjtē.

Tē rēndonin thasët,
tē kish grurë lumë;
magjja te shtëpia
tē mbushej me brumë.

Tē qeshnin fëmija,
tē gatuante nëna;
pragun te shtëpia
ta ndriçonte hëna.

* * * * *

Atë ditë lufta e zuri nē arë
kur zbriste tē shihte shtëpinë.
Pëshpëriste gruri e i thosh:
«E gëzofshim së bashku lirinë!»

Lofatat degët ulnin ngadalë,
nga ledhi vinte një fllad i freskët;
ca duaj gruri rrinin në arë
si luftëtarë të mirë, si roje të ndershëm.

Dhe heshti gjyshi tek e pa grurin,
grurin që kish futur në çdo ëndërr,
po hijet e zeza që vinin drejt tij
e shponin si tyrjelë në zemër.

E gjyshinofullat shtrëngon mes arës,
e pushkën përmbi kallnj e ngre, —
plumba e grurë i ranë në ballë.
e këngën prenë zogjtë në fole.

E tokën përkëdhel me duar ai,
e puth të mirën në buzë e ballë —
ishte e puthura e fundit e tij
mes grurit të përgjakur në arë.

Dhe sytë hap e vështronin tej,
ca zëra që zgjaten, ca këngë vijnë;
i dukej sikur gruri i thosh në vesh:
«E gëzofshim së bashku lirinë!»



Dhe liria erdhi
e qeshur, e bardhë;
dyert gjithë i çeli
brenda në mëhallë.

U rritën fëmija
dhe burra u bënë;
dritë kish shtëpia
netët kishin hënë.

Pemët çelën sythe,
zemrat çelën këngë
e ëndrra e gjyshit,
bir, nuk ngeli ëndërr . . .

P A S Q Y R A E L E N D E S

Për veten	3
Lirika e nënës.....	5
Gurë dhe thëllëza	7
Lirikë	8
Ku ishe mbrëmë ti?	9
Vajzave në valle	11
Kur çelin lulet e qershise	12
Asaj që shpejt do të rritet	13
Këngë më vete për Vjollcën.....	14
Aroma e grurit të pjekur	15
Peisazh	16
E çastit	18
Imazh fëminie	19
Hapi sytë e zes	20
Vargje për partizanin Veli	21
Ore mullixhi	23
Partizanit Aleks.....	25
Dhjetë ushtarë	26
Në vendlindje	28
Ç'më mbani mëri?	29
Do të jetë mëngjes	31
Sofikës së Kolonjës	32
Vjeshtë	34
Këngë e re mbi brazda çel	35
Endrra e mjelëses	37

Në Lukovë	38
Vëllai	39
Naftëtari Braho	40
Vajza e fabrikës së qelqit	41
Nën diellin e korrikut	42
Mëngjes	43
Do të vije	44
Lule mbi burime	46
Poemë për gjyshin	47